

Letërnjoftimi i Komunës së

**VITISË**

**2014**

Maj, 2015





## Fakte


- Të hyrat buxhetore të Komunës së Vitisë më 2014 kanë shënuar rritje prej 200 mijë euro në krahasim me një vit më parë.
- Në administratë komunale janë të punësuar 191 persona, apo një shërbyes civil për 250 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Vitia ka edhe së paku 6 të punësuar me kontratë mbi vepër. Këta të punësuar me kontratë mbi vepër janë të angazhuar për periudha mbi një vjeçare.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 805 persona, prej tyre 666 mësimdhënës. Në Komunën e Vitisë raporti nxënës/mësimdhënës është 34.6. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 155 persona. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Vitisë është 308.2. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Vitia gjatë vitit 2014 ka pasur 2,683 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Viti rreth 5.6% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 171 biznese të reja.
- Gjatë vitit 2014 janë shuar 22 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.
- Kryetari i Vitisë Sokol Haliti gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 13 premtime nga fushat e ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 30%, apo mbi mesatare në shkallë vendi, e cila është 24%.

## 2 Qeverisja komunale

Komuna e Vitisë në zgjedhjet e fundit lokale (2013) ka kaluar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në qeverisjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Kryetari aktual i Vitisë z.Sokol Haliti (LDK) ka fituar mandatin pas balotazhit, i zhvilluar mes tij dhe ish Kryetarit nga radhët e PDK-së z.Nexhmedin Arifi.


Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 21,038 apo rreth 46% qytetarë me të drejtë vote. Në balotazhin e mbajtur me 1 dhjetor 2013, Sokol Haliti ka marr 34,6%, ndërsa Nexhmedin Arifi ka fituar me 23,7%.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave në raundin e parë dhe në balotazh



Zgjedhjet për Kuvend Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: LDK 9 ulëse, PDK 6 ulëse, AAK – LDD 5 ulëse, VV 5 ulëse, AKR dhe Ekrem Abazi me nga një ulëse.

Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Vitisë në bazë të zgjedhjeve 2013




Ekzekutivi komunal i Vitisë ka 10 drejtori.

### 3 Buxheti i Komunës së Vitisë

Më 2014, Komuna e Vitisë kishte buxhet prej 9.6 milion eurove, me një rritje mbi 1 milion euro në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje për 1,151 të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë. Buxheti për investime kapitale është 2.4 milion euro, një rritje rreth 500 mijë euro në krahasim me dy vitet paraprake.


**Grafikoni nr. 3** Buxheti total i Komunës së Vitisë dhe kategoritë kryesore buxhetore



Instituti GAP

Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Vitisë ishin 877 mijë euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2013.


**Grafikoni nr.4** Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Vitisë 2011-2015



Instituti GAP


Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë afro 30% të të hyrave të përgjithshme.

**Grafikoni nr.5** Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komunitet tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Vitisë ka arritur të mbledh më shumë të hyra nga tatimi në pronë se sa komuna si Shtime, Skenderaj, Istog, Klinë, etj., ndërsa më pak se sa, Vushtrri, Suhareka, etj.

**Grafikoni nr.6** Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë




Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, telefona mobil, telefona fiks, shpenzime për mëditje jashtë vendit, kanë shënuar rënie të dukshme në krahasim me një vit më parë, përveç shpenzimeve për udhëtime jashtë vendit ku kemi pasur një rritje, ashtu siç mund të shihet nga figura 7.

**Grafikoni nr. 7** Shpenzimet për disa kategori buxhetore



Komuna e Vitisë gjatë vitit 2014 ka shpenzuar për energji elektrike rreth 107 mijë euro, apo 21 mijë euro më shumë krahasuar me një vit më herët, për ujë 37 mijë euro, apo 10 mijë euro më shumë sesa viti paraprak, kurse për mbeturina kemi një ulje të shpenzimeve për 12 mijë euro nga 32 mijë euro sa ishte në vitin 2013.


**Grafikoni nr. 8** Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve



## 4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Vitia e ka përmbyllur me 1.151 të punësuar në sektorin publik, 28 më shumë se sa një vit më parë. Përgjatë këtij viti, janë punësuar 10 shërbyes civil më shumë në kuadër të administratës, 7 punonjës në sektorin e arsimit dhe 11 në sektorin e shëndetësisë.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Vitisë



Komuna e Vitisë ka të punësuar një shërbyes civil për 250 banorë. Në krahasim me komunat tjera, Vitia ka më shumë të punësuar në administratën lokale, në krahasim me popullsinë që ka. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori






Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Vitia ka edhe së paku 6 të punësuar me kontratë mbi vepër. Këta të punësuar me kontratë mbi vepër janë të angazhuar për periudhë mbi një vjeçare.

Grafikoni nr.11 Të punësuar me kontratë mbi vepër




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 805 persona, prej tyre 666 mësimsdhënës. Në Komunën e Vitisë raporti nxënës/mësimsdhënës është 34.6. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimsdhënës në Komunën e Vitisë



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 155 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Vitisë është 308.2. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



## 5 Ekonomia lokale

Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 171 biznese të reja, një numër më i vogël sesa që ishin regjistruar në dy vitet paraprake. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare.


Grafikoni nr.14 Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Instituti GAP

Gjatë vitit 2014 janë shuar 22 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë nga fusha e tregtisë.

**Grafikoni nr.15** Llojet e bizneseve të shuara më 2014



Në përgjithësi, Vitia radhitet ndër komunat me probleme të mëdha ekonomike, për shkak të papunësisë së lartë dhe ambientit jo të favorshëm të të bërit biznes.

## 6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Sokol Haliti gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 13 premtimet e monitoruara, del se deri në maj 2015 z. Haliti ka arritur të realizoj 30% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

**Grafikoni nr.16** Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





**Instituti GAP**

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2  
+381 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)  
[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)  
[www.komunat.institutigap.org](http://www.komunat.institutigap.org)

